

Valdrin Krasniqi, PhD, është Profesor Asistent i Psikologjisë Industriale dhe Organizative në Kolegjin UBT, ku ligjeron dhe mentoron studentë në fusha si lidërshipi, sjellja organizative, menaxhimi i burimeve njerëzore, sjellja konsumatore dhe psikologjia e komunikimit. Përveç rolit të tij akademik, ai kontribuon në zhvillimin e kurrikulave, mbështet kërkimin studentor dhe promovon një mjedis mësimor praktik, bashkëpunues dhe inovativ. Ai gjithashtu shërben si Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ku luan një rol thelbësor në qeverisjen strategjike, rritjen e efikasitetit operativ, forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe orientimin e strategjisë afatgjatë energjetike të vendit.

Dr.Krasniqi,sjell më shumë se një dekadë përvojë profesionale ndërkombëtare nga PETRONAS, një kompani globale e renditur në Fortune 500, ku ka mbajtur pozita të larta në financa, menaxhimin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe iniciativat e transformimit digjital. Puna e tij përfshinte udhëheqjen e operacioneve financiare multimilionëshe, negociatat me partnerë ndërkombëtarë dhe drejtimin e proceseve të digjitalizimit që përmirësuan vendimmarrjen dhe funksionimin organizativ.

Interesat e tij kërkimore përfshijnë klimën psikososiale të sigurisë, lidërshpin fuqizues, angazhimin në punë, mirëqenien e punonjësve dhe performancën organizative. Ai është autor i disa publikimeve në revista ndërkombëtare dhe ka prezantuar punimet e tij në konferenca shkencore jashtë vendit. Duke kombinuar ekspertizën akademike me përvojën e thelluar në industri, Valdrini vazhdon të kontribuojë në ndërthurjen e psikologjisë organizative me zhvillimin e lidërshit dhe menaxhimin strategjik.